Kosovo Judicial Institute
Instituti Gjyqësor i Kosovës
Kosovski Institut za Pravosudje

OSCE Building ID no 47, 99 Ramiz Sadiku Street
Tel: +(381-38) 248-688/689
Fax: +(381-38) 248-688/204

BULETINI I IGJK-së
Nëntor dhjetor 2005

Ky Buletin është publikuar për informim sa më të plotë të gjyqësisë së Kosovës rreth veprimtarisë së IGJK-së. Ky publikim i është shpërndarë gjyqtarëve dhe prokurorëve në gjithë Kosovën. Buletini mujor i IGJK-së tani përmban artikuj nga stafi i IGJK-së në lidhje me çështjet me interes për gjyqtarët dhe prokurorët që punojnë në Kosovë.

Prezantimi i sistemit për aplikim të trajnimeve

Mandati i Institutit Gjyqësor të Kosovës (IGJK) është që të trajnoi gjyqtarët dhe prokurorët, në atë mënyrë që të kontribuoi në zhvillimin e një gjyqësori dhe organeve të ndjekjes profesionale dhe të paanshme në Kosovë.

Për të përmbushur mandatin e vet IGJK vazhdimisht përshtat veprimtarinë e vet trajnuese sipas ndryshimit të ambientit juridik dhe nevojave. Një hap tjetër të cilin IGJK do ta bëjë në vazhdën e zhvillimit të trajnimit profesional gjyqësor në Kosovë është prezantimi i sistemit të aplikimit në vend të sistemit të ftesave për trajnim. Sistemi i aplikimit parasheh një rol pro-aktiv për gjyqtarët dhe prokurorët të cilët do të aplikojnë për trajnimet për të cilat janë të interesuar, në vend se kjo iniciative të iu lihet Institutit që ai të bëjë përzgjedhjen e pjesëmarrësve për ngjarjet trajnuese. Sistemi i aplikimit është një sistem shumë i përdorur nëpër Institucione për Trajnime Gjyqësore në tërë botën dhe besohet të jetë një sistemi shumë efikas. Ky sistem iu ofron mundësinë gjyqtarëve dhe prokurorëve që të hartojnë vetë orarin e tyre individual të trajnimit sipas interesave dhe nevojave të tyre të sakta trajnuese. Pas prezantimit, ky sistem, do të jetë shumë i leverdishmi edhe për IGJK-në. Do të mundësoi IGJK-në që të planifikoi më mirë veprimtaritë e veta trajnuese dhe do të jetë gjithmonë në hap me interesat e trajnimit profesional për gjyqtarët dhe prokurorët.
Sistemi i aplikimit parasheh që, pasi gjyqtarët dhe prokurorët ta kenë pranuar programin vjetor të trajnimit të IGJK-së si dhe kalendarin e trajnimit për çdo tremujor të aplikojnë shumë më herët për sesionet e preferuara trajnuese. Pas datës përfundimtare për dorëzimin e aplikacioneve personeli i IGJK-së do të përgatit listat përfundimtare të pjesëmarrësve të cilët do të marrin pjesë në trajnim.
Së bashku me lansimin e sistemit të ri në këtë buletin do të bashkëngjitet edhe kalendari i trajnimit i IGJK-së. Instituti Gjyqësor i Kosovës inkurajon të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët që të aplikojnë për veprimtaritë trajnuese të paraqitura në kalendar duke dorëzuar aplikacionet. Aplikacionet për trajnim mund të gjenden te të gjithë kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorit e Kosovës.

Kosovo Judicial Institute
Instituti Gjyqësor i Kosovës
Kosovski Institut za Pravosudje

OSCE Building ID no 47, 99 Ramiz Sadiku Street
Tel: +(381-38) 248-688/689
Fax: +(381-38) 248-688/204

Instituti Gjyqësor i Kosovës ju dëshiron shumë suksese në vitin 2006!

Projekt Aktivitetet nëntor/dhjetor 2005

Punëtori- Mbrojtja kundër dhunës në familje

Kjo punëtori u mbajt më 15 nëntor 2005. Në bazë të vlerësimit të trajnimeve të bërë më herët, kjo punëtori u përqendrua më shumë në aspekte praktike të implementimit të rregullores 2003/12. Pjesëmarrësit patën mundësinë të diskutojnë mbi rastet e ndryshme me të cilat ata janë ballafaquar gjatë praktikës së tyre gjyqësore dhe kështu të ndajnë përvojën e tyre me të tjerët dhe njëherit kanë shprehur brengat e tyre për rregulloren pas dy viteve të zbatimit të saj. Agjenda e trajnimit përfshinte edhe një pasqyrim të përgjithshëm të legjislacionit vendor, procedurën të cilën duhet të ndërmerret sipas rregullores dhe llojet e ndryshme të urdhrave mbrojtës të cilët mund të lëshohen, raste të shqyrtimit të bazuar në praktikën gjyqësore. Në mënyrë që të lehtësohet diskutimi, IGJK në këtë punëtori jo vetëm që ftoi gjyqtarët të cilët gjykojnë raste nga lëmia përkatëse e dhunës në familje por ftoi edhe përfaqësues nga Qendra Rajonale për Punë Sociale në Prishtinë, Njësitin për avokim dhe ndihmë të viktimave të UNMIK-ut, policë të SHPK-së etj. Kjo punëtori u mbajt në ndërtesën e IGJK-së në Prishtinë.

Seminar për Kundërvajtjet

Më 17 nëntor 2005 IGJK organizoi sesionin tjetër trajnues për një grup të Gjyqtarëve nga Gjykatat për Kundërvajtje. Ky seminar është vazhdimësi e një sërë trajnimesh të ngjarjeve trajnuese të ofruara nga IGJK për Gjyqtarët për kundërvajtje. Agjenda trajnuese përfshinë veprat kundërvajtëse nga Kodi i ri Penal, diskutime rreth rasteve kur të miturit përfshihen në këto procedura dhe procedura e gjykatës në rast të parashtrimit të ankesës. Seminari u mbajt në ndërtesën e IGJK-së në Prishtinë.

Punëtori mbi të drejtën penale – dënimet, llojet e dënimeve, dënimet alternative

Më 23 nëntor 2005 IGJK organizoi një punëtori me temën e lartpërmendur. Temat e diskutuara në këtë punëtori u përqendruan në procedurat penale sipas dispozitave të kodit penal dhe atij të procedurës penale të Kosovës. Ky trajnim ofroi diskutime interaktive për pjesëmarrësit përkitazi me çështjet diskutabile gjatë llogaritjes së dënimeve, llojet e dënimeve dhe dënimet alternative. Diskutimet e përqendruan kryesisht në rastet nga praktika dhe procedurën specifike për seancat e gjykatës në rastet penale. Punëtoria mbajt në ndërtesën e IGJK-së në Prishtinë.

OSCE Building ID no 47, 99 Ramiz Sadiku Street
Tel: +(381-38) 248-688/689
Fax: +(381-38) 248-688/204

Trajnimi i trajnuesve (TIT)

Gjatë periudhës raportuese IGJK në bashkëpunim me Këshillin e Evropës (KE) ka përfunduar sesionet e fundit të TIT për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut për njëzet gjyqtar dhe prokuror të zgjedhur. Pjesa e fundit e programit trajnues për gjyqtarët dhe prokurorët vendor kishte për qëllim zhvillimin e aftësive të tyre specifike dhe të rrisë edhe më shumë diturinë e tyre juridike dhe profesionale si trajnues të ardhshëm në frymën e aplikimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjatë programit trajnues në dhjetor, i cili ishte përfundim i semestrit të dytë të TIT, pjesëmarrësve iu ofrua një test përfundimtar pas përfundimit të cilit gjyqtarët dhe prokurorët e zgjedhur do të shërbejnë si trajnues të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për KE-në dhe IGJK-në. Ekspertët ndërkombëtar mbajtën trajnim dhe vlerësuan rezultatin përfundimtar të këtij trajnimi.

Seminar: Ekspropriijimi dhe kompensimi

Më 6 dhjetor 2005 IGJK organizoi një seminar me temën e lartpërmendur për gjyqtarët të cilët shqyrtojnë raste nga e drejta pronësore në mënyrë që me këtë të harmonizohet praktika gjyqësore në raste të tilla. Tema kryesore e seminarit u përqendrua në procedurën civile të ndërlidhur me ekspropriijimin dhe kompensimin, de-ekspropriijimin dhe kërkesat për kompensim sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë. Profesionist të shquar vendor prezantuan aspekte të ndryshme të temës së lartpërmendur për pjesëmarrësit. Seminari u mbajt në ndërtesën e IGJK-së në Prishtinë.

Tryezë e rrumbullakët: Privatizimi në Kosovë

Më 8 dhjetor 2005, IGJK organizoi një tryezë të rrumbullakët për temën e lartpërmendur për gjyqtarët të cilët shqyrtojnë raste nga e drejta pronësore në mënyrë që të përmbushet kërkesa e gjyqtarëve për më shumë trajnime nga lëmi i privatizimit sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë. Temat e Diskutuara u përqendruan kryesisht në praktikën gjyqësore të dhomës së posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me AKM-në si dhe pasojat specifike juridike të cilat duhet të merren para sysh nga gjyqtarët të cilët shqyrtojnë raste të tilla. Profesionist të shquar vendor prezantuan aspekte të ndryshme të temës së lartpërmendur për pjesëmarrësit. Tryeza u mbajt në ndërtesën e IGJK –së në Prishtinë.

Seminar: Luftimi kundër pastrimit të parave, Korrupsionit dhe krimeve të ngjashme Ekonomike

Më 12 dhjetor 2005 IGJK organizoi një seminar me temën e lartpërmendur. Temat e diskutuara në seminar përfshinin hetimet, ndjekjen, dhe procedurat pranë gjykatës në rastet të cilat dalin prej veprave të lartpërmendura. Trajnues të shquar vendor dhe ndërkombëtar prezantuan disa nga çështjet më sfiduese pranë kolegëve të tyre dhe ndihmuan diskutimet të cilat çuan deri te qartësimi i atyre çështjeve në mesin e profesionistëve ligjor. Seminari u mbajt në ndërtesën e IGJK-së në Prishtinë.

OSCE Building ID no 47, 99 Ramiz Sadiku Street
Tel: +(381-38) 248-688/689
Fax: +(381-38) 248-688/204

Seminar nga e drejta e BE-së

Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) organizoi një seminar mbi të Drejtën e Bashkimit Evropian më 13 dhe 14 dhjetor 2005. Temat e diskutuara në këtë seminar u përqendruan në të drejtën e BE-së dhe inkorporimin e tyre në të drejtën e shteteve anëtare, ligjet doganore të BE-së dhe të shteteve Ballkanike, Ligjet e Tatimeve në BE dhe shtetet ballkanike, si dhe disa shembuj ballkanik nga praktika e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Një ekip i fortë i ekspertëve ndërkombëtar prezantuan temat e lartpërmendura për kolegët e tyre Kosovar. Seminari u mbajt në ndërtesën e IGJK-së në Prishtinë

Ngjarjet e Ardhshme

Trajnim i Trajnuesve (TOT)

Në dhjetor të vitit 2005 IGJK ka planifikuar të organizoi një TIT të specializuar për dy grupe të gjyqtarëve dhe prokurorëve Kosovar. Trajnimi është caktuar të mbahet në Ohër të Maqedonisë. Secili grup do të përbëhet nga tetëmbëdhjetë (18) gjyqtar prokuror të cilët janë të angazhuar si trajnues në IGJK. Grupi i parë do të mbajë Trajnim themelor të trajnuesve kurse grupi i dytë të Avancuar. Dy trajnues ndërkombëtar do të mbajnë programin trajnues për secilin grup në IRJM. Trajnimi do të zgjasë 5 ditë për secilin grup.

Datat e planifikuara janë: 15-21 Dhjetor 2005

Punëtori nga e Drejta civile (e drejta familjare)
Grupi përfitues: Gjyqtarët të cilët shqyrtojnë raste nga e drejta familjare

Duke pasur para sysh ndryshimet e pritura në të drejtën familjare në Kosovë, IGJK ka planifikuar të organizoi një punëtori me temën e lartpërmendur. IGJK mëton që të lehtësoi harmonizimin e praktikës gjyqësore në rastet e prishjes së martesës sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë dhe sipas të drejtës ndërkombëtare mbi çështjet martesore. Në cilësinë e trajnuesve dhe ekspertëve në këtë punëtori do të jenë profesionistët e shquar ligjor nga e gjithë Kosova. Punëtoria do të mbahet në ndërtesën e IGJK-së në Prishtinë.
Data e planifikuar: 17 janar 2006

OSCE Building ID no 47, 99 Ramiz Sadiku Street
Tel: +(381-38) 248-688/689
Fax: +(381-38) 248-688/204

Punëtori nga KPPPK: Paraburgimi, paraburgimi i personave me të meta mendore
Grupi përfitues: gjyqtarët dhe prokurorët të cilët shqyrtojnë rastet nga lëmia penale
Tema e lartpërmendur është parë si një sfidë në praktikën e gjyqtarëve dhe prokurorëve Kosovar, të cilët ballafaqohen me shumë vështirësi në aplikimin e KPPPK-së kur kanë të bëjnë me paraburgimin e posaçërisht paraburgimin e personave me të meta mendore. disa nga trajnuesit vendor më me përvojë do të mbajnë sesionin trajnues dhe t'i ndihmojnë diskutimet. Punëtoria do të mbahet në ndërtesën e IGJK-së në Prishtinë.
Data e planifikuar: 24 janar 2006.

Punëtori nga KPPPK: Simulimi i gjykimit
Grupi përfitues: Gjyqtarët dhe prokurorët e lëmisë penale
Simulimi i ka dëshmuar të jetë një nga format më efikase dhe më të preferuara të trajnimit nga gjyqtarët dhe prokurorët nga rajoni i Prishtinës, IGJK ka caktuar sesionin e lartpërmendur si një simulim të tërë procedurës gjyqësore. Moderator të këtij sesioni do të jenë trajnuesit nga IGJK, Kryetari i Gjykatës së Qarkut, Prokuroritë e Qarkut nga rajoni i Prishtinës.

Data e planifikuar: 26 janar 2006.